

Shkolla e mesme I



Cikli 3

Klasët 1. – 3. të Shkollës së mesme

Shkolla e mesme lidhet në shkollën fillore dhe vazhdon misionin arsimor. Të rinjtë përgatiten për një shkollim profesional ose shkollë tjetër arsimuese. Shkolla mbështet të rinjtë dhe edukuesit në procesin e zgjedhjes së profesionit. Pas shkollës së mesme, të gjithë nxënësit duhet të kenë një mundësi të përshtatshme për t'u bashkuar (praktikë profesionale apo shkollë e mesme).

Shkolla e mesme zgjat tre vjet.

Ndahet në tre nivele sfiduese:

Sekundare B: kërkesat themelore, përgatitja për mësimin profesional

Sekundare E: kërkesa të zgjëruara, përgatitje për mësim (me ose pa maturitet profesional) ose shkollë të mesme profesionale

Sekundare P: drejtim Gjimnazit dyvjeçar, kërkesa të larta, përgatitje për kalim në Gjimnaz

Përfundimi i shkollës popullore/fillore obliguese

Nxënësit marrin në fund Çertifikatën përfundimtare të Shkollës popullore. Ajo iu jep informata mbi kontributat e arritura.

Përgjegjësitë

Udhëheqja e shkollës, mësuesit dhe prindërit kuptohen si partnerë në aspektet edukuese dhe arsimuese. Mirëqenia e fëmijës është në qendër. Bashkëpunimi i mirë midis shkollës dhe prindërve është i rëndësishëm për zhvillimin e nxënësve dhe suksesin e tyre në shkollë. Bashkëpunimi i rregulluar qartë është një veçori cilësore e shkollave të mira. Vendimet e rëndësishme diskutohen bashkërisht nga shkolla dhe prindërit.

Shkolla dhe mësuesit sigurojnë një klimë progresive mësimi, transferimin e njohurive dhe funksionim të rregullt shkollor. Shkolla i informon prindërit për ngjarje të rëndësishme në jetën shkollore dhe i kupton seriozisht informatat, vëzhgimet, shpresat dhe shqetësimet e zhvillimit të fëmijëve. ShërbimPsikologjik Shkollorë është në dispozicion të shkollës dhe prindërve.

Nxënësit janë të obliguar të përcjellin njëmbëdhjetë vite shkollim (nga kopshti deri në vitin e tretë të shkollës së mesme). Ata i përmbahen rregullave të shkollës për bashkëjetesë dhe përcjellje shkollorë të rregullt. Nxënësit gjithnjë e më shumë punojnë në mënyrë të pavarur dhe marrin përgjegjësi për mësimin dhe veprimin e tyre. Me mbështetjen e prindërve dhe shkollës, ata përgatiten për zgjedhjen e profesionit.

Prindërit mbështesin fëmijët e tyre në rrugën e tyre arsimore dhe në procesin e zgjedhjes së profesionit. Ata skujdesen që fëmijtë e tyre të gjejn kushte të mira për të mësuar edhe jashtë shkollës. Ata punojnë me mësuesit sëbashku dhe ndihmojnë afëmijëve ti pmbahen rregullave shkollorë. Aty i takon edhe pjesëmarrëja e plotë në ligjerata. Nga prindërit pritet të marrin pjesë në takimet informative të shkollës. Në rast pyetjesh, paqartësive ose situata sfiduese arsimore, prindërit e kontaktojnë mësuesin e klasës me iniciativën e vetë. Në raste konfliktesh me mësime nxënës, Drejtoria e shkollës është partner i bisedimeve.

Informata të hollësishme rreth shkollës në Komunën tuaj, iu jep nga Drejtoria e shkollës.

Shkolla popullore në pasqyrë




Informacione të mëtejshme

Mësuesit dhe administratorët e shkollës
Enti shkollor popullor Solothurn

Nën vsa.so.ch mund të kontaktoni:

– fletushka në gjuhë të ndryshme

– broshurë e hollësishme në gjermanisht



Volksschulamt

Kreuzackerstrasse 1

4502 Solothurn

Telefon 032 627 29 37

vsa@dbk.so.ch

vsa.so.ch

Mirrëseardhje

në shkollat popullore të Solothurnit


Shkolla fillore e kantonit të Solothurnit ka për detyrë t'u sigurojë fëmijëve dhe të rinjve një arsim të gjerë të përgjithshëm dhe t'i mbështesë ata në zhvillimin e tyre në personalitete të pavarura.

Në mënyrë që kjo detyrë të realizohet, shkolla ka nevojë për mbështetjen e të gjithë shoqërisë. Bashkëpunimi i mirë midis shkollës dhe shtëpisë prindrore është i rëndësishëm për suksesin shkollor dhe zhvillimin e fëmijës.

Urimet e mia më të mira shoqërojnë fëmijët dhe adoleshentët në rrugën e tyre arsimore dhe profesionale.

Andreas Walter

Shefi i Entit të Shkollës popullore



E vlerëshme të dihet për shkollat e Solothurnit

Çdo fëmijë ka të drejtë dhe obligim të ndjekë shkollën fillore. Shkolla fillore përfshin kopshtin, shkollën fillore dhe të mesme dhe zgjat njëmbëdhjetë vjet. Është falas për të gjithë. Fëmijët dhe adoleshentët marrin një arsim bazë, i cili iu jep mundësinë e aftësimin profesional ose shkollave tjera adekuate arsimuese. Ofertat dhe qëllimet e kompetencës janë të njëjta për vajzat dhe djemtë. Viti shkollor fillon mesin e gushtit dhe përfundon në fillim të korrikut.

Shkolla fillore është një detyrë e përbashkët e kantonit, komunave dhe prindërve.

Për nxënësit që kanë nevojë për ndihëm plotsuese përveç mësimave të rregullta, janë edhe ofertat e përkrahjes speciale në dispozicion. Kompensimi i disavantazhit është çështje vetëkuptueshme. Fëmijët me aftësi të kufizuara ndjekin shkollën në oferta jashtëzakonshme të shkollës.

Shkalla fillore

Cikli 1

1./2. Çerdhja e fëmijëve dhe klasat 1./2. të shkollës fillore

Fëmijët hyjnë në kopsht pas moshës katër vjeçare. Zakonisht, ata frekuentojnë kopshtin e fëmijëve në vendbanimin e tyre. Pas këshillimit me Drejtorinë e shkollës, prindërit mund të vendosin, a do të regjistrohet fëmiju i tyre një vit më vonë. Regjistrimi i mëhershëm është i përjashtuar.

Fëmijët do të mbështeten në kopsht në të gjitha fushat e zhvillimit. Ata bëhen më të pavarur, lëvizin në një grup moshatarësh dhe mësojnë, të kontribuojnë diçka për bashkësi.

Në klasën e parë dhe të dytë të shkollës fillore nxënësit fitojnë aftësi themelore, siç janë leximi, shkrimi dhe matematika dhe njohuri për mjedisin/ambientin.


Cikli 2

Klasat e 3. – 6. të shkollës Fillore

Në ciklin e dytë, fëmijët do të përkrahen në një gamë të gjerë lëndësh profesionale. Nga klasa e tretë ata mësojnë frëngjisht, nga klasa e pestë vjen edhe anglishtja. Arritjet në lëndët vlerësohen dhe regjistrohen në certifikatë. Arritjet në punë, mësim-dhe sjellje sociale, vlerësohen dhe regjistrohen gjithashtu në certifikatë.

Shkolla fillore e nje diplomimin automatik, fëmijët do të regjistrohen principiell në klasën tjetër më të lartë.

Procedura e transferimit në shkollë dytë-I. është e rregulluar me ligjin kantonal.



Karriera e shkollës me një shikim

Kantoni i Solothurnit ofron një ofertë e gjerë të mundësive arsimore, në mënyrë që fëmijët dhe adoleshentët të mund të zhvillohen në bazë të aftësive dhe

prirjeve të tyre. Grafiku më poshtë jep një përmbledhje. Për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, është në dispozicion një ofertë speciale arsimore.

Tertiärstufe	Tertiärstufe: Berufs- und höhere Fachprüfungen, Höhere Fachschulen, Fachhochschulen, Pädagogische Hochschulen, Universitäten, Eidgenössische Technische Hochschulen, (ETH/EPFL)			Schuljahr 16		
	Sekundarstufe II	Berufsmaturitätsausbildung lehrbegleitend (3 oder 4 Jahre) oder anschliessend an Berufslehre: 1 Jahr Vollzeit bzw. 1 1/2 Jahre Teilzeit	Fachmaturität	Schuljahr 15		
Fachmittelschule			Gymnasium	Schuljahr 14		
		Schuljahr 13				
Brückenangebote			Schuljahr 12			
Ende der obligatorischen Volksschule						
Sekundarstufe I	Zyklus 3	3. Klasse	Sekundarschule B + E	Schuljahr 11		
				2. Klasse	Sek P	Schuljahr 10
				1. Klasse		Schuljahr 9
Primarstufe	Zyklus 2	6. Klasse	Primarschule	Schuljahr 8		
				5. Klasse	Schuljahr 7	
				4. Klasse	Schuljahr 6	
	Zyklus 1	3. Klasse	Primarschule	Schuljahr 5		
				2. Klasse	Schuljahr 4	
				1. Klasse	Schuljahr 3	
Kindergarten	Primarschule	2. Klasse	Kindergarten	Schuljahr 2		
				1. Klasse	Schuljahr 1	



Shkolla e mesme I
Sekundare B
Sekundare E
Sekundare P

Sekundarstufe I
Sek B
Sek E
Sek P

Shkalla fillestare
Kopshti fëmijësh
Shkolla fillore

Primarstufe
Kindergarten
Primarschule